



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DURRËS**

Nr. 1176 Prot.

Durrës, më 04.05 2022

SHPALLJE 3

**E VENDEVE TË LIRA PËR PSIKOLOG/PUNONJËS SOCIAL NE NJSHC TË
INSTITUCIONEVE PUBLIKE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR (IPAP),**

Drejtorja Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durrës , në zbatim të Ligjit 69/2012 “Për arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM nr.99, datë 27.02.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”, Urdhrit nr. 313, datë 20.10.2020 “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psiko-social në institucionet e arsimit parauniversitar dhe procedurat e emërimit, pezullimit dhe largimit në shërbimin psiko-social”, shpall vendet e lira për psikologo/punonjës social në institucionet arsimore publik të arsimit parauniversitar IPAP si më poshtë:

Nr	DRAP	ZVAP	Pozicioni	Institucioni Arsimor	Vakant/Provizor
1	Durrës	Tiranë	Psikologe	Gjimnazi "Arben Broci"	Zëvendësim leje lindje
2	Durrës	Tiranë	Psikologe	Shkolla 9-vjeçare "Osman Myderizi"	Zëvendësim leje lindje
3	Durrës	Tiranë	Psikologe	Shkolla 9-vjeçare "Siri Kodra"+ Murat Toptani	Zëvendësim leje lindje
4	Durrës	Tiranë	Psikologe	SHMB Krrabe+Mangull+Haki Shehu+Tagan,Ramazan Dervishi + Stermas	Zëvendësim leje lindje
5	Durrës	Tiranë	Psikologe	SHMBA Jordan Misja	Zëvendësim raport mjeksor
6	Durrës	Tiranë	Psikologe	Mersin Duqi Ibe	Zëvendësim leje lindje

7	Durrës	Tiranë	Punonjës Social	Androkli Kostallari	Zëvendësim leje lindje
8	Durrës	Kamëz	Psikologe	100 Vjetori+Lidhja e Prizrenit	Zëvendësim leje lindje
9	Durrës	Dibër	Psikologe	Gjimnazi "Fiqeri Dine"Maqellar	Vakant
10	Durrës	Dibër	Psikologe	SHMB Arras,Lurë, 9 -vjeçare Grykë Noke,Sine,Mustaf	Vakant
11	Durrës	Bulqizë	Psikologe	Shefqet Tançi ,Demokracia,Jashar Kola,Ismail Jangulli	Vakant

Kriteret për tu punësuar në Shërbimin Psiko Social:

1.Kritere të përgjithshme:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të jetë kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejnë detyrën përkatëse;
- Të mos jetë dënuar me vendim të formës të prerë për kryerjen e një vepre penale
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;

2.Kërkesa të veçanta:

- Të jetë i pajisur të paktën me diplomën e ciklit të parë të studimeve në fushën përkatëse;
- Të zotëroj njohuri bazë në kompjuter
- Zotërimi i gjuhëve të huaja përbën avantazh (dëshmi, certifikata);

3.Psikologu /Punonjësi Social ka formim si vijon :

- Psikologu duhet të ketë të paktën diplomë të ciklit të parë dhe/ose diplomë të ciklit të dytë ose ekuivalente në fushën e psikologjisë, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 80/2015.
- Punonjësi Social duhet të ketë të paktën diplomë të ciklit të parë dhe/ose diplomë të ciklit të dytë ose ekuivalente në fushën e Punës Sociale në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 80/2015.

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- Jetëshkrim sipas shtojcës nr.3 të këtij Urdhëri
- Kërkesë për pjesmarrje në konkurrimin për pozicionin psikolog/punonjës social
- Raport mjeko-ligjor i tri muajve të fundit (e detyrueshme)

d) Deklaratë për verifikimin e vërtetësisë së dokumentave të paraqitura nga kandidati sipas shtojcës 4, të këtij urdhëri. (e detyrueshme)

e) Formular vetëdeklarimi i gjendjes gjyqësore sipas shtojcës 5 të këtij urdhëri (e detyrueshme)

f) Fotokopje e librezës së punës e noterizuar (nëse ka)

e) Kopje e njësuar me orgjinalin e diplomës/diplomave, vërtetimin /listës së notave të studimeve të larta(cikli i parë, cikli i dytë dhe diplomat e integruara të ciklit të dytë)ose ta barazvlefshme me këto sipas përcaktimeve të legjislacionit ne fuqi. (e detyrueshme)

i) Kopje të njësuar me orgjinalin të licencës për ushtrimin e profesionit (nëse ka)..

k) Dëshmi të gjuhës/gjuhëve të huaja të mbrojtuar (nese ka)

l) Çertifikatë personale e tri muajve të fundit.. (e detyrueshme)

Nëse në dosjen e aplikimit mungon nje nga dokument e detyrueshëm atëherë kandidati skualifikohet automatikisht.

Në rastet kur për të njëjtin vend pune ka më shumë se 1 kërkesë do të bëhet rankim sipas shtojcës nr.2 të Urdhërit nr.313, datë 20.10.2020. punonjësi me më shumë pikë zgjedh vendin e punës.

Dokumentacioni i sipër shënuar do të dërgohet brenda datës 09.05.2022 në DRAP Durrës në rrugë postare në adresën :

Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durrës.

Lagja nr.3, rruga "Egnatia",

Kutia postare 2001, Durrës

DREJTOR

Ana DHAMO

